



**Kuvendi i Komunës Klinë**

01Nr. 06-20998 /2024

Datë: 03.07 /2024

*Duke u mbështetur në Nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimin e KPF-së datës: 07.06.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VI-të të rregullt për vitin 2024, të mbajtur me datën: 28.06.2024 mori këtë:*

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për transfer të mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi -300) fondi burimor 10.
  - 1.1.Nga programi **Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural** (470), nën-programi **Bujqësia-Klinë** (47018), kodi funksional (0421) nga kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “**Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Budisalc-Jagode-Radulloç, Poterq - Dollovë**”, kodi i projektit (54346), shuma prej **19,847.00 €**, të transferohet në:
  - 1.2.Programin **Planifikimi Urban dhe Mjedisi** (660), nën-programi **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni** (66395), kodi funksional (0620) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “**Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan)**”, kodi i projektit(54341) shuma **9,763.00 €**.
  - 1.3.Programin **Planifikimi Urban dhe Mjedisi** (660), nën-programi **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni** (66395), kodi funksional (0620) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “**Ndërtimi i segmenteve dhe infrastrukturës nëntokësore të rrugës Ymer Berisha, Drini i Bardh, Skender Rexhepi, Abedin Rexha, Mehmet Haxhaj, Haxhi Zeka**”, kodi i projektit(54272) shuma **1,781.13 €**.

1.4. Programin **Shëndetësia dhe mirëqenia sociale** (730), nën-programin **Shërbimet e shëndetësisë primare** (74050) me kod funksional (0721) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300), fondi 10, projekti **“Ndërtimi i nxemjes qendrore me pompa termike ne QKMF Kline“**, kodi i projektit (54361), shuma **6.000.00 €**.

1.5. Programin **Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia** (180), nën-programin **Infrastruktura Rrugore - Klinë** (18018) me kod funksional (0451) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300), **fondi 10**, projekti **“Ndërtimi i rrjetit te ndriçimit publik Krushevë e Vogël-Madhe, Drenovc, Qeskovë, Jashanice, Leskoc, Ranoc “**, kodi i projektit (54353), shuma **2,302.87 €**.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
3. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- **MAPL;**
- **Kryetari i Komunes;**
- **Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi;**



**Kryesues i Kuvendit**  
**Fadil Gashi**